

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”  
FAKULTETI I EDUKIMIT**



**PUNIM DIPLOME**

**ANITA HAJRA**

**Mitrovicë, 2021**

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”  
FAKULTETI I EDUKIMIT**



# **PUNIM DIPLOME**

**NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË MËSIMIN E  
GJUHËS ANGLEZE TEK NXËNËSIT E  
CIKLIT FILLOR NË RRETHIN E  
MITROVICËS**

Mentori:  
Prof.Ass.Dr. Edita Bekteshi

Kandidatja:  
Anita Hajra

Mitrovicë, 2021

**UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”  
FACULTY OF EDUCATION**



# **DIPLOMA THESIS**

**INFLUENCE OF TECHNOLOGY ON ENGLISH  
LANGUAGE LEARNING OF PRIMARY SCHOOL  
STUDENTS IN MITROVICA DISTRICT**

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi

Candidate:

Anita Hajra

Mitrovica, 2021

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”  
FAKULTETI I EDUKIMIT  
PROGRAMI FILLOR**



## **PUNIM DIPLOME**

**Titulli i punimit:** Ndikimi i teknologjise ne mesimin e gjuhes angleze tek nxwnwsit e ciklit fillor ne rrethin e Mitrovicews.

**Emri dhe mbiemri:** Anita Hajra

**Statusi i studentit:** E rregullt

**Numri i amzës (ID Regjistri):**1506011112

**Niveli i studimeve:** Bachelor

**Programi i studimit:** Fillor

**Mentori e punimit:** Prof.Ass.Dr. Edita Bekteshi

**Aprovuar prej komisionit:**

1. Prof.Ass.Dr. \_\_\_\_\_, mentor

2. Prof.Ass.Dr. \_\_\_\_\_, anëtar

3. Prof.Ass.Dr. \_\_\_\_\_, anëtar

Data e aprovimit: \_\_\_\_\_

## **DEKLARATË E AUTOROSISË**

Unë, Anita Hajra, deklaroj me vetëdije dhe ndërgjegje të plotë që ky punim” Ndikimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze tek nxënësit e ciklit fillor në rrethin e Mitrovicës” është rezultat i punës sime të pavarur dhe nuk është prezentuar asnjëherë më parë nga askush para një instiucioni tjetër për vlerësim. Përveç rasteve të cituara dhe referuara, punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër.

## **FALËMNDERIM**

Me shumë respekt falënderoj profesoreshwn - mentoren time Prof.Ass.Dr. Edita Bekteshi, për kontributin e dhënë dhe këshillat në realizimin e sukseseve të punës, e cila e ndoqi këtë studim hap pas hapi.

Dëshiroj të shprehi falënderim edhe për Universitetin e Mitrovicës dhe për të gjithë profesorët e Fakultetit të Edukimit për përgatitjen time profesionale.

Po ashtu falënderoj shoqërinë dhe të gjithë ata që u bënë pjesë e këtij rrugëtimi dhe përjetuan çdo arritje apo sukses timin së bashku me mua.

Një falënderim shumë të madh do ia dedikoj familjes sime, të cilët më ndihmuan dhe më dhanë mbështetje të pazezervuar në shkollimin dhe ngritjen time akademike.

Falënderit të gjithëve!

# **PËRMBAJTJA**

DEKLARATË E AUTOROSISË .....	5
FALËMNDERIM .....	6
LISTA E TABELAVE.....	8
LISTA E GRAFIKËVE .....	9
LISTA E SHKURTESAVE.....	10
Abstrakt.....	11
Abstract.....	12
1.HYRJE .....	13
1.1. Teoritë e përvetësimit të gjuhës .....	15
1.2. Përdorimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze .....	16
1.3. Avantazhet e përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze.....	17
1.4. Disavantazhet e përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze .....	19
1.5. Aftësitë teknologjike për mësimin e gjuhës angleze .....	20
1.6. Roli i mësuesve në përdorimin e teknologjisë .....	22
1.7. Studime të mëparshme mbi përdorimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze .....	24
2. METODOLOGJIA .....	25
2.1. <i>Pjesëmarrësit</i> .....	25
2.2. <i>Instrumenti</i> .....	26
2.3. <i>Mënyra e mbledhjes së të dhënave</i> .....	26
2.4. <i>Analizat</i> .....	26
2.5. <i>Apekti etik</i> .....	27
2.6. <i>Kufizimet e hulumtimit</i> .....	27
3. REZULTATET .....	28
4. DISKUTIME.....	34
5. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET .....	36
REFERENCAT.....	38
SHTOJCA.....	41

## LISTA E TABELAVE

**Tabela 1:** Të dhënat përshkruese për gjinin, grup moshën, vendbanimin dhe përvojën e punës të pjesëmarrëve në hulumtim.

**Tabela 2:** Mesi aritmetik dhe Devijimi Standard sipas Gjinisë kundrejt Konstrukteve të Instrumentit

**Tabela 3:** Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard për Konstruktet e Instrumentit

**Tabela 4:** Të dhënat përshkruese për pyetjet 6 dhe 4

**Tabela 5:** Të dhënat deskriptive për moshën, përvojën e punës dhe trajnimet e ndjekura

**Tabela 6:** Te dhënat përshkruese për pyetjet 4 dhe 9



## **LISTA E GRAFIKËVE**

**Grafiku 1:** Numri i trajnimeve që mësime të mësimdhënësit kanë ndjekur për përdorimin e teknologjisë në klasë

**Grafiku 2:** Numri i laboratorëve të kompjuterëve në shkollë

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**DKA** – Drejtoria Komunale e Arsimit

**SPSS** – Paketë për shkencat sociale (**S**tatistical **P**ackage for the **S**ocial **S**ciences)

**TIK** – Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

**UG** – Teoria e Gramatikës Universale

**CLT**– Mësimi i Gjuhës Komunikuese

## Abstrakt

Qëllimi i hulumtimit është të kuptojmë ndikimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze tek nxënësit e ciklit fillor në rrethin e Mitrovices, si dhe rëndësinë që ka përdorimi i teknologjisë tek nxënësit si në mësimin ashtu edhe në përvetsimin e një gjuhe të dytë sic është gjuha angleze.

Pjesëmarrës të hulumtimit kanë qenë 15 mësimdhënës të shkollave fillore klasa 1-9 dhe të kurseve të gjuhës angleze të Komunës së Mitrovicës.

Për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur pyetësor të gatshëm nga hulumtimet “Teaching and Learning with Technology: Effectiveness of ICT Integration in Schools” 2015, me autor Simin Ghavifek dhe “Foreign language teachers’ technology beliefs and implementation factors: a mixed methods study” 2016, me autor Brittany Ann Garling.

Këta pyetësorë janë lejuar të përdoren nga të gjithë me lejen e autorit. Pyetësori përbëhet prej 24 pyetje, ku këtu përfshihen edhe pyetjet demografike. Pyetësori pastaj është ndarë në dy seksione, në pjesa e pare e cila përbëhet nga 6 pyetje demografike që lidhen me grup moshën, gjininë, vendbanimin dhe përvojën e punës dhe në seksionin e dytë që janë gjithsej 18 pyetje të ndara në 5 konstrukte siç janë: përdorimi i TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze, motivimi i nxënësve, qasja pozitive e mësimdhënësve, integrimi i TIK-ut dhe menaxhimi i klasës. Pastaj, të dhënat e mbledhura janë përpunuar përmes programit për analizën e të dhënave statistikore SPSS 21 (Paketës Statistikore për Shkencat Shoqërore) domethënë, pas futjes së të dhënave u përdorën analizat përshkruese për të prezantuar konstruktin e shprehur nëpërmjet mesatares aritmetike (MA) dhe devijimit standard (DS). Për dallimet ndërmjet grupeve, u përdor T–testi.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se ndikimi i teknologjisë është shumë i madh në mësimin e gjuhës angleze si në motivimin e nxënësve ashtu edhe në menagjimin e klasës. Gjithashtu gjetjet e këtij hulumtimi konstatuan dallime ndërmjet mësimdhënësve të gjinisë femrore dhe gjinisë mashkullore, në konstruktet e instrumentit.

Fjalët kyçe: mësimdhënësit, nxënësit, teknologjia, ndikimi.

## **Abstract**

The purpose of the research is to understand the impact of technology on English language learning among elementary school students in the county of Mitrovica, as well as the importance of using technology with students in both learning and acquiring a second language than English. Fifteen teachers of elementary schools from grades 1 to 9 and English courses from the Municipality of Mitrovica participated in the research.

For the realization of this research, pre-made questionnaires from the research "Teaching and learning with technology: effectiveness of ICT integration in schools" 2015 by Simin Ghavifek and "Technological beliefs and implementation factors of foreign language teachers: a mixed methods study "2016, by Brittany Ann Garling were used.

These questions are allowed to be used by all with the permission of the author. The questionnaire consists of 24 questions, which include demographic questions. The questionnaire is then divided into two sections, in the first part which consists of 6 demographic questions related to age group, gender, place of residence and work experience and in the second section which are a total of 18 questions divided into 5 constructs, such as: Use of ICT- in the classroom in teaching English, student motivation, positive teacher approach, ICT integration, and classroom management. Then, the collected data were processed through the program for statistical data analysis SPSS 21 (Statistical Package for Social Sciences) that is, after entering the data descriptive analysis was used to present the construct expressed through arithmetic mean (MA) and deviation standard (DS). For differences between groups, T-test was used.

The research results show that the influence of technology on English learning is very high in both student motivation and classroom management. The results of this research also found differences between female and male teachers in the constructs of the instrument.

**Keywords:** teachers, students, technology, impact.

## 1.HYRJJE

Përdorimi i teknologjisë në të gjitha proceset jetësore është kthyer dhe është bërë një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxënësve, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. TIK-u, si aftësi funksionale e lexim-shkrimit digjital, nxit dhe zhvillon të nxënësit një sërë aftësish të tjera, të tilla si: aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi menaxhuese, aftësi të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh etj. Mirëpo dukuri shqetësuese është se TIK-u në masë të madhe po keqpërdoret nga nxënësit duke qëndruar orë të tëra pranë kompjuterit dhe duke e përdorur për lojëra të ndryshme (Shehu, 2020).

Sipas Shehu (2020), TIK-u ka lehtësuar shumë përditshmërinë tonë ashtu edhe në fushën e arsimit, në mesimin dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja. Përdorimi multimedial, aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në përvetësimin e gjuhëve ka ndryshuar dinamikën e jetës në ditët e sotme, sidomos në fushën e arsimit. Qasja inovative në sistemin e informacionit rezulton në krijimin e lidhjeve ndërmjet gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Mësimi përmes internetit, si dhe teknologjia e avancuar i jep hapësirë nxënësve, studenteve në përvetësimin dhe shfrytëzimin e resurseve të shumëllojshme gjuhësore. Gjithashtu Shehu (2020) thekson se shumë procese komplekse dhe kritike mund të zgjidhen më lehtë me ndihmën e teknologjisë moderne. Aplikimi i kompjuterit, mësimi online interneti, fjalori elektronik, Audio Kasete, Power Point, Video, DVD i ofrojnë mësimdhënësve dhe nxënësve mundësi për zgjidhjen e problematikave të shumta.

Hoven (1999) thekson se teknologjia ofron burime të të nxënësve dhe ju ofronë nxënësve mundësi të mëdha për t'u bërë nxënës të pavarur. Kështu, Mujtaba (2013) & Hoven (1999) pajtohen që teknologjia ofron më shumë përmbajtje dhe burime dhe ndihmon për t'u bërë më autonome.

Sa i përket komunikimit ndërkombëtar, gjuha është një nga elementët domethënës që ndikon në aktivitetet ndërkombëtare të komunikimit. Studentët përdorin pjesë të ndryshme të aftësive në gjuhën angleze si dëgjimi, të folurit, leximi, dhe duke shkruar për aftësinë dhe komunikimin e tyre (Grabe, 2020). Kurse sipas Ybarra (2003) studentët që përpiqen të mësojnë anglisht si gjuhë të dytë kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme gjuhësore. Ata duhet të praktikojnë në gjuhë dëgjimi, gjuhë leximi, gjuhë të folurit dhe gjuhë shkrimi në mënyrë që të zhvillojnë gjuhën e tyre.

Për të bërë detyra të tilla, ata kanë nevojë të përdorin mjete të ndryshme gjë që mund t'i ndihmojë ata të mësojnë gjuhën angleze më lehtë dhe në mënyrë efektive.

Becker (2000) thotë se kompjuterët konsiderohen si një instrument i rëndësishëm udhëzues në orët e gjuhës angleze në të cilat mësuesit kanë qasje të përshtatshme, janë përgatitur mjaftueshëm dhe kanë një farë lirie në kurrikulë. Kompjuterët dhe teknologjia konsiderohet nga shumë mësues si pjesë e rëndësishme e sigurimit të një cilësie të lartë edukimi. Gjithashtu kjo është përkrahur edhe nga Eady (2013), i cili thekson se teknologjia ka qenë gjithmonë një pjesë e rëndësishme e mjedisit mësimor dhe të të nxënës dhe është një pjesë thelbësore e profesionit të mësuesve përmes së cilës ata mund ta përdorin atë për të lehtësuar nxënësit të mësuarit. Kur flasim për teknologjinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, përdoret fjala 'integrim'. Meqë teknologjia është pjesë e jetës sonë të përditshme, është koha të rimendojmë idenë e integritit të teknologjisë në kurrikulë dhe të synojmë të fusim teknologjinë në mësimdhënie për të mbështetur të mësuarit si proces. Kjo do të thotëse, teknologjia bëhet një pjesë integrale e përvojës së të mësuarit dhe një çështje domethënëse për mësuesit, nga fillimi i përgatitjes së përvojave të të mësuarit deri tek procesi i mësimdhënies dhe të të nxënës.

Kurse sa i përket metodave të mësimdhënies, studiuesit mbështetën pikëpamjen se metoda e mësimdhënies është ndryshuar për shkak të teknologjisë dhe zbatimi i teknologjisë i ndihmon nxënësit të mësojnë në bazë të interesave të tyre. Ai gjithashtu i kënaq të dy shqisat vizuale dhe dëgjimore të nxënësve (Solanki, 2012).

Lam (2002) dhe Pourhossein Gilakjani (2017) thonë se teknologjia ndihmon nxënësit në rregullimin e procesit të tyre të të mësuarit dhe ata mund të kenë qasje në shumë informacione që mësuesit e tyre nuk janë në gjendje t'i sigurojnë.

### **1.1. Teoritë e përvetësimit të gjuhës**

Janë propozuar disa teori të me qëllim që të shpjegojnë aspektet e procesit të përvetësimit të gjuhës. Në këtë kuptim, qëllimi kryesor i çdo teorie është të përpiqet të japë llogari dhe të shpjegojë përvetësimin e gjuhës nga nxënësit me një larmi karakteristikash në kontekste të ndryshme (Lightbown, 2006). Të tilla janë: Teoria e Bihaviorizmit, Teoria e Gramatikës Universale, Kognitivizmi, Teoria Sociokulturore.

**Teoria e Bihaviorizmit** u zhvillua gjatë viteve 1940 dhe 1970, veçanërisht në Amerikën e Veriut. Kjo teori vizualizon mësimin (dhe jo vetëm mësimin e gjuhës) nën konceptet e imitimit, praktikës, përforsimit dhe formimit të zakonit (Lightbown, 2006).

Një nga metodat më përfaqësuese të mësimdhënies në lidhje me teorinë e Bihaviorizmit është Metoda Audio-Gjuhësore. Kjo metodologji ishte shumë e popullarizuar në vitet 1960 dhe 1970 dhe bazohet në të mësuarit përmes formimit të zakoneve. Kështu, aktiviteti në klasë ndjek procedurën e mëposhtme: studentët dëgjojnë një audio që përmban struktura dhe modele të veçanta dhe ata duhet të përsërisin në mënyrë që t'i kuptojnë pikat gramatikore, siç janë format e foljeve dhe strukturat e fjalive. Prandaj, studentët fillimisht mësohen të dëgjojnë dhe flasin, dhe pastaj të lexojnë dhe shkruajnë (Cook, 2008c).

**Teoria e Gramatikës Universale (UG)** u propozua nga Noam Chomsky në 1980 dhe ajo lindi nga perspektiva innatiste. Sipas UG procesi i përvetësimit të gjuhës së dytë është sigurisht i ngjashëm me procesin e gjuhës së parë, atëherë nxënësit nuk kanë nevojë të mësojnë gramatikë në mënyrë që t'a mësojnë; ajo që ata në të vërtetë kanë nevojë janë stimujt ose inputet e duhura gjuhësore për t'u bërë folës të rrjedhshëm (Myles, 2002).

**Kognitivizmi** pretendon se të mësuarit e gjuhës nuk është plotësisht ndryshe nga aktivitetet e tjera që përfshijnë procesin e të mësuarit, pra, është rezultat i krijimit të rrjeteve dhe shoqatave që ndodhin në trurin e njeriut (Myles, 2002).

**Teoria Sociokulturore**, e konceptuar fillimisht nga Lev S. Vygotsky, supozon se zhvillimi i gjuhës shfaqet si rezultat i ndërveprimeve shoqërore. Ky propozim përpiqet të llogarisë mënyrat në të cilat nxënësit mund të fitojnë qasje në njohuri të reja në lidhje me gjuhën kur ata kanë mbështetje nga një bashkëbisedues. Prandaj, parimi kryesor i kësaj teorie është se të mësuarit e gjuhës është në thelb një ndërmjetësim shoqëror midis nxënësit dhe dikujt tjetër. (Cook, General models of L2 learning, 2008b).

## 1.2. Përdorimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze

Teknologjia e mësimin të gjuhës filloi të përdoret shekuj më parë nëse e konsiderojmë dërrasën e zezë gjithashtu si teknologji (Dudeney, 2007).

Kurse përdorimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze mendohet se filloi në vitet 1950. Që atëherë, sistemi arsimor pësoi një transformim mbresëlënës. Dudeney (2007) përmend magnetofonët dhe videot që janë në përdorim që nga vitet 1960 dhe 1970, dhe janë akoma përdoret në klasat në të gjithë botën. Që nga vitet 1980 (gjenerata e parë e PC), zhvillimi i teknologjisë ka përshpejtuar këtë transformim me shfaqja e metodologjive dhe burimeve të reja për mësimin e gjuhës angleze. Prandaj, në dekadat e fundit teknologjia është përfshirë në ndryshime të mëdha në mënyrën e mësimdhënies dhe të mesuarit në anglisht.

Në klasat tradicionale, mësuesit qëndrojnë përpara nxënësve dhe mbajnë leksione, shpjegim dhe udhëzim përmes përdorimit të dërrasës së zezë ose dërrasës së bardhë. Këto metoda duhet të jenë ndryshuar në lidhje me zhvillimin e teknologjisë. Përdorimi i teksteve multimediale në klasë ndihmon nxënësit të familjarizohen me fjalorin dhe strukturat gjuhësore. Zbatimi i multimedias gjithashtu përdor tekste të shtypura, film dhe internet për të përmirësuar gjuhësinë e nxënësve dhe njohuritë. Përdorimi i shtypit, filmit dhe internetit u jep nxënësve mundësinë për të mbledhur informacione dhe u ofron atyre materiale të ndryshme për analizën dhe interpretimin e gjuhës dhe konteksteve (Arifah, 2014).

Sipas Merzifonluoglu (2018) zbatimi i teknologjia në mësimin e gjuhës angleze ka konceptuar mundësi të reja për nxënësit dhe mësuesit. Kjo është potencuar nga Arnó (2012) dhe Merzifonluoglu (2018) të cilët bien dakord se teknologjia ka ndryshuar perspektivat për të mësuar edhe në gjuhën angleze dhe ata besojnë se teknologjia po ndihmon nxënësit dhe mësuesit për të përmirësuar mësimin në anglisht.

Në ditët e sotme, integrimi i teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze është bërë shumë mjet i rëndësishëm. Gholamina (2014) pretendon se tani teknologjia na ofron mënyra dhe burime mësimore të ndryshme për të krijuar një mjedis stimulues, motivues dhe dinamik për të mësuar gjuhën angleze. Bile kjo është potencuar më herët edhe nga Dudeney & Hockley (2007) deklarojnë se teknologjia po bëhet gjithnjë e më shumë e rëndësishme, dhe do të bëhet një pjesë e zakonshme e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze vitet e ardhshme. Ata



argumentojnë se arsyet janë aksesimi më i madh në Internet dhe se nxënësit që janë rritur në epokën dixhitale.

Sa i përket mësimnxënies së gjuhës së huaj, respektivisht gjuhës angleze, Baytak (2011) kryen studim mbi rolin e teknologjisë në mësimin e gjuhës. Rezultatet zbuluan se të mësuarit e nxënësve u përmirësua duke integruar teknologjinë në klasë. Nxënësit deklaruan se përdorimi i teknologjisë në shkollë e bën mësimin të kënaqshëm dhe i ndihmon ata të mësojnë më shumë. Nxënësit gjithashtu thanë që teknologjia e bën mësimin interesant, të kënaqshëm dhe interaktiv. Rezultati tjetër i këtij studimi ishte se përdorimi i teknologjisë rrit motivimin e nxënësve, ndërveprimet shoqërore, të mësuarit dhe angazhimin.

Përdorimi i internetit rrit motivimin e nxënësve. Përdorimi i filmit në mësimdhënie i ndihmon nxënësit të kuptojnë temën me entuziazëm dhe të zhvillojnë njohuritë e tyre. Por qëndrimet e mësimdhënësve ndikojnë në mënyrën e implantimit të teknologjisë në klasa. Si rezultat, mësimdhënësit meshkuj ata refuzojnë përdorimin e teknologjive kompjuterike dhe nuk i integrojnë këto burime në mësimet e tyre. Kurse mësimdhënset femra kombinojnë multimediat dhe metodologjinë e mësimdhënies që është shumë e rëndësishme për të tërhequr vëmendjen e nxënësve drejt mëimit të gjuhës angleze (Arifah, 2014).

Gjithashtu zbatimi i teknologjisë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në anglisht. Ai ofron aq shumë alternativa sa që e bën mësimdhënien dhe mësimnxënien më interesante dhe më produktive në drejtim të përparimit (Patel, 2013).

### **1.3. Avantazhet e përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze**

Ka shumë autorë që janë të favorizuar ndaj përdorimit të teknologjive të reja në gjuhën angleze. Pavarësisht nga disa disavantazhe, duket se shumë pedagogë dhe studiues pozicionojnë më shumë në favor të përdorimit të TIK.

Sipas Mujtaba (2013) përdorimi i kompjuterëve në mësim dhe në mësimin anglishtës mund të ofrojë një larmi të gjerë të përmbajtjes multimediale dhe kanaleve të tjera të komunikimit midis nxënësve. Mujtaba (2013) gjithashtu shpjegon se teknologjia ka ndihmuar në ndryshimin e qasjeve të përqendruara tek mësuesit në drejtim të atyre me në qendër nxënësin. Studentët janë

bërë nxënës më aktivë duke rritur autonominë e tyre. I njëjti autor beson se nxënësit mund të vendosin vetë për objektivat e tyre të të nxënës.

Përdorimi i teknologjisë në klasë inkurajon nxënësit anglezë të nxisin suksesin e tyre në Gjuhën Angleze (Cutter, 2015). Teknologjia ofron shumë mundësi për të mësuar gjuhë sesa metodologjitë tradicionale. Prandaj, mësuesit kanë shumë burime dhe materiale që mund t'i përdorin në mësimet e tyre. Cutter (2015) gjithashtu shpjegon se teknologjia rrit motivimin. Studentët bëhen më të motivuar kur punojnë në kompjuter dhe përdorin pajisje moderne sesa kur punojnë me tekste shkollore. Ata shpesh janë më pak të shpërqendruar dhe mësuesi mund të zgjedhë mësimet personale për secilin nxënës bazuar në nevojat e tyre. Për më tepër, studentët mund të plotësojnë njohuritë e tyre duke përdorur pajisjet e tyre në shtëpi.

Po ashtu teknologjia ofron një larmi të burimeve për të dëgjuar dhe zhvilluar aftësitë gjuhësore të shoqëruara. Teknologjia gjithashtu ofron një larmi të gjerë të mundësive të të mësuarit të kontekstit gjuhësor dhe aktiviteteve ndërvepruese, shumica në një kontekst real (Mujtaba, 2013).

Autonomia është bërë një çështje qendrore në mësimin e gjuhës, veçanërisht pasi zhvillimet e teknologjisë kanë lehtësuar:

- a) “qasjen në një gamë të gjerë të materialeve autentike në modalitete të ndryshme (teksti, audio, imazhi, video, etj.);
  - b) mundësia e ndërveprimit dhe shkëmbimit me partnerët në të gjithë botën dhe
  - c) një shkallë më e madhe e iniciativës dhe kontrollit të nxënësit mbi materialet dhe aktivitetet”
- Arnó 2012, fq. 96.

Nga njëra anë, Mujtaba (2013) & Arnó (2012) bien dakord që teknologjia ofron një larmi të madhe përmbajtjesh dhe burimesh dhe gjithashtu siguron kontekst të vërtetë dhe ndërveprim real me njerëz në të gjithë botën. Nga ana tjetër, Arnó argumenton se teknologjia gjithashtu u jep nxënësve autonomi. Për më tepër, Arnó (2012) thotë se "teknologjia siguron qasje në tekstin autentik, mjetet për analizën e tyre dhe burimet e komunikimit në internet. Po ashtu është bërë gjithashtu një mjet i fuqishëm për të lehtësuar zhytjen e studentëve në komunitetin e ligjërimit” (Arnó 2012, fq. 92). Kështu, Arnó (2012) gjithashtu pajtohet me avantazhet që Mujtaba (2013) ka përmendur më parë.

Mollaei (2013) thekson se implementimi i teknologjisë në klasa është bërë një ndryshim i rëndësishëm i mësimdhënies. Teknologjia rrit atmosferën në klasë, dhe nxënësit mund të menaxhojnë vetë procesin e tyre të të mësuarit. Klasa bëhet më e përqendruar te nxënësi.

Gjithashtu edhe Mohaded (2014) vëren se teknologjia i lejon studentët të përfshihen në vende dhe kontekste të jetës reale dhe kuptimplote dhe prezanton lloje të ndryshme materialesh. Të dy autorët Mollaei (2013) dhe Mohaded (2014) pajtohen se teknologjia është e dobishme për nxënësit. Rrit motivimin dhe ofron mundësi për të mësuar në një kontekst kuptimplotë

#### **1.4. Disavantazhet e përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze**

Megjithëse ka shumë përparësi në përdorimin e TIK (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) sic janë përmendur më lartë ka disa autorë që hulumtojnë në lidhje me disavantazhet e përdorimit të TIK në mësimin e gjuhës angleze. Imad (2015) pohon se mungesa e investimeve në teknologji është pengesa më e rëndësishme që mësuesit gjejnë kur duan të përdorin teknologjinë në klasat e tyre. Imad (2015) gjithashtu argumenton se një i paafte në njohuritë teknike të TIK-ut në lidhje me teknologjinë mund të jenë gjithashtu një problem. Shumë mësues nuk janë mjaft kompetentë për të përdorur TIK në mënyrë efektive.

“Mangësitë dhe kufizimet e instrumenteve teknologjike, mbështetjet financiare, mungesa e kohës, mungesa e informacionit rreth mënyrës së përdorimit të llojeve të ndryshme të pajisjeve teknologjike dhe programeve dhe mungesa e kurseve efektive të trajnimit janë sfidat që dekurajojnë trajnimin e mësimin të gjuhës dhe progresin e mësuesve” (Imad 2015, fq. 85)

Pourhosein (2015) thekson aksesin e kufizuar në Internet si një pengesë. Ka akoma vende ku interneti nuk ka pikat e nevojshme të hyrjes. Përveç kësaj, mbështetja joadekuate e teknologjisë kompjuterike në harduer / softuer është gjithashtu një pengesë. Kompjuterët kanë nevojë për mirëmbajtje. Për këtë arsye, mungesa e mirëmbajtjes bën që kompjuterat të prishen dhe të ndalojnë së punuari. Prandaj, Pourhosein (2015) përmend se mungesa e ndihmës teknike në shkolla për të riparuar kompjuterët dhe lidhjet e Internetit për të vazhduar përdorimin e TIK-ut si një pengesë tjetër.

Sa i përket aftësive të përdorimit të internetit, mësuesit kanë përvojë të pamjaftueshme me teknologjinë, mungesë besimi, mungesë lehtësirash dhe mungesë trainimi. Për më tepër, përgatitja e materialeve kërkon kohë dhe shpesh mësuesit nuk janë në dispozicion. Mohamed gjithashtu pretendon se mësuesit shpesh janë më pak të aftë sesa studentët e tyre që përdorin

TIK. Kështu, Mohamed (2014) pajtohet me autorët e tjerë që mësuesit kanë nevojë për trajnim teknologjik për të dhënë mësim duke përdorur TIK. Me trajnim të mjaftueshëm të TIK-ut, mësuesit mund të jenë më kompetentë dhe të kalojnë më pak kohë duke përgatitur materiale. Një disavantazh është se kërkon kohë dhe përpjekje që mësuesit të gjejnë materiale autentike. Ata mund të kalojnë shumë kohë duke mësuar vazhdimisht duke ndryshuar programe softuerësh dhe duke u përpjekur të gjejnë mënyrën më të mirë për t'i përdorur këto programe në klasë (Mohamed 2014, fq. 11)

Dudney (2007) dhe Mohamed (2014) flasin për një mungesë të përgjithshme të trajnimit të TIK për mësuesit. Ata gjithashtu besojnë se mësuesit kanë nevojë për më shumë kompetencë teknologjike dhe shtojnë se disa mësues duan të përdorin më shumë teknologji, por shkollat nuk janë të pajisura mjaftueshëm.

### **1.5. Aftësitë teknologjike për mësimin e gjuhës angleze**

Në 20 vitet e fundit, teknologjia ka përparuar në mënyrë të pandalshme. Çdo ditë shfaqen programe të reja dhe pajisje të reja. Sidoqoftë, studiuesit këmbëngulin në përfitimet nga përdorimi i TIK në mësimin e gjuhës angleze. Për këtë arsye, disa prej tyre janë përpjekur të kategorizojnë pajisjet teknologjike për secilën aftësi mësimore (të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit).

Nga njëra anë, Basheer (2013), fq. 111 beson se "secili mjet teknologjik ka përfitimet dhe zbatimin e tij specifik me njërin nga katër pjesët gjuhësore" Si pasojë, Basheer (2013) ka organizuar mjetet teknologjike rreth aftësive të të mësuarit:

- a) "Aftësitë e dëgjimit (Kompjuter, transmetim, CD-Players dhe TapRecorders...)
- b) Shkathtësitë e leximit (Programet e bazuara në leximin kompjuterik, programet multimediale, shfletimi i internetit, fjalorë elektronikë)
- c) Shkathtësitë e të shkruarit (Kompjuter, email, biseda me tekst në internet)
- d) Aftësitë e të folurit (Biseda me zë në Internet, Programet e Sintezës së Shpejtësisë)" Basheer (2013), fq. 111.

Po ashtu, Carrier (2017), klasifikon mjetet teknologjike në kategoritë e mëposhtme:

- a) Teknologjitë e hyrjes, të cilat përdorin mjete teknologjike për t'u treguar studentëve materiale të reja mësimore, të tilla si tabela të bardha interaktive, projektorë dhe kufje të realitetit virtual.
- b) Teknologjitë interaktive, të cilat përfshijnë pajisje dhe softuer që fuqizojnë studentët të prodhojnë gjuhë dhe të bashkëveprojnë me materiale, të tilla si kuize në internet, konferenca video etj.
- c) Teknologji portative, të tilla si telefonat, tabletët, pajisjet e votimit, ekranet me montim në kokë dhe të tjera.

Për dallim nga Carrier (2017) i cili kategorizon teknologjitë, Basheer (2013) klasifikon aftësitë e gjuhës angleze në aftësitë hyrëse (të dëgjuarit dhe leximit) dhe aftësitë e daljes (të folurit dhe të shkruarit). Aftësia e të dëgjuarit “është procesi i identifikimit dhe kuptimit të fjalës së folësve”. I njëjti autor beson se përdorimi i TIK-ut në aftësitë e dëgjimit i pajis nxënësit me të dhëna vizuale dhe zanore të cilat mund të përmirësojnë informacionin, idetë e tyre, dhe si pasojë të rrisin aftësitë e tyre të dëgjimit.

Përdorimi i TIK si një mjet dëgjimi u jep studentëve mundësinë për të mësuar në mënyrë të pavarur dhe për të marrë reagime të menjëhershme. Gjithashtu është e dobishme për të mësuar dhe përmirësuar aftësitë e të folurit dhe që nxënësit mund të përdorin mjete teknologjike për të folur me njerëz në të gjithë botën që flasin anglisht (Hoven, 1999). Për më tepër, "të mësuarit e fjalorit duke përdorur kompjuterë i ndihmon nxënësit të marrin fjalor në mënyrë të konsiderueshme më shpejt sesa mënyra tradicionale e mësimit të fjalorit" (Mujtaba, 2013, fq. 65).

Sa i përket leximit Stanley (2013) shkruan, "Leximi është një aftësi komplekse shumëplanëse dhe nocionet se si të mësohet më mirë leximi kanë qenë në rishikim të vazhdueshëm, veçanërisht me rritjen e Internetit" (Stanley 2013, fq.147). Gjithashtu është e rëndësishme që mësuesit të dinë strategjitë më të mira për të lexuar në media të reja dhe t'i mësojnë ato për studentët. Stanley thekson se leximet në Internet kërkojnë strategji të reja të grupuara zakonisht nën termin e shkrim-leximit dixhital.

Kurse procesi i të shkruarit mund të jetë një detyrë shumë e vështirë për nxënësit e anglishtes sepse ata kanë nevojë për të prodhuar ide dhe për t'i porositur ato me një përdorim të mirë të gramatikës dhe fjalorit. Me rritjen e internetit, shkrimi ndoshta është aftësia më e prekur. Shfaqja

e aplikacioneve të reja, të tilla si biseda, smartphone dhe komunikimi i menjëhershëm, ka lënë të kuptohet se shkrimi përmes një ekrani është rritur ndjeshëm midis përdoruesve. Për më tepër, ka shumë mjete për të inkurajuar nxënësit të shkruajnë (Blogje, grupe ose rrjete sociale, histori interaktive, portofole elektronike...) (Basheer, 2013).

Peregoy (2012) kryen një studim mbi përdorimin e teknologjisë në përmirësimin e aftësive të leximit dhe shkrimit të nxënësve. Rezultatet e këtij studimi treguan se mjetet e teknologjisë rritën aftësitë e leximit dhe të shkruarit të nxënësve sepse ato janë miqësore dhe përdoruesit mund të mësojnë në një mënyrë më të shpejtë dhe më efektive. Gjetja tjetër e këtij studimi ishte se ata që mësojnë më shumë mësojnë në mënyrë më efektive kur përdorin mjete teknologjike në vend të metodës tradicionale të mësimdhënies sepse interneti siguroi një mjedis të favorshëm për të mësuarin e nxënësve, lehtësoi një platformë të re për nxënësit të cilët mund të kenë një mundësi të përshtatshme për mësimet.

Gjithashtu edhe të folurit ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë, ku përdorimi i teknologjisë mund të stimulojë nxënësit të flasin me të tjerët dhe regjistrimi i nxënësve është një nga mënyrat më idenetike për t'i inkurajuar ata. Mund t'i ndihmojë ata të përmirësojnë aftësitë e tyre të folurit. Sipas Stanley disa mjete të dobishme janë: Skype, softuer për redaktimin e audios, regjistruarit e zërit, telefonia në Internet, telefona celularë, kamera në internet, lojëra kompjuterike dhe botë virtuale (Stanley, 2013).

### **1.6. Roli i mësuesve në përdorimin e teknologjisë**

Roli i mësuesve nuk është vetëm transmetimi i informacionit, por edhe sigurimi i mjeteve të reja për të marrë njohuri (Mollaei, 2013).

“Mësuesit duhet të përdorin një proces të hartimit udhëzues në të cilin përcaktojnë rezultatet e nevojshme, të planifikojnë qëllimet e të mësuarit dhe më pas të zgjedhin teknologjinë e cila është më e përshtatshme për të arritur ato qëllime të të mësuarit” (Marek, 2014, p. 10). Klasa moderne merr informacion nga të dhëna të ndryshme (teknologjike dhe njerëzore). Prandaj, teknologjia ndryshon mënyrën e mësimdhënies, por mënyra se si mësuesit organizojnë mësimet e tyre dhe zgjedhjen e materialeve më të mira për secilin qëllim mësimor është gjithashtu e rëndësishme (Bárcena, 2014).

Kurse George (2013) mendon se teknologjia mund të pasurojë mënyrën se si ne mësojmë. Roli i ri i mësimdhënies është i përqendruar te nxënësi dhe mësuesit bëhen udhëzues gjatë procesit të të nxënies. Gholaminia (2014) shkruan, "Roli ynë si mësues në epokën teknologjike nuk është vetëm të ndikojmë në njohuri të reja, por t'u japim studentëve mjetet për të marrë njohuri" (Gholaminia 2014, fq.377). Për më tepër, mësuesit nuk do të jenë në gjendje të përballen me rolin e tyre të ri nëse nuk janë mjaftueshëm kompetentë për TIK.

Përsëri Pourhosein (2015) argumenton se ekziston një lidhje midis përvojës kompjuterike të mësuesit dhe qëndrimeve të tyre përpara TIK-ut. Sipas tij, mësuesit më të vjetër ose mësuesit me më shumë përvojë mësimore janë më pak të prirur të përdorin TIK. Përkundrazi, mësuesit e rinj kanë më pak vështirësi për të përdorur teknologjinë në mësimet e tyre. Nga kjo mund të nënkuptohet se pengesat e mësuesit janë mungesa e trajnimit teknologjik dhe niveli më i ulët i aftësive që lidhen me të. Kjo është vërtetuar edhe nga pohimi i Cutter (2015) i cili shkruan se "është e domosdoshme që mësuesit të marrin udhëzime mbi strategjitë për të përdorur teknologjinë. Kjo mundësi do t'i ndihmojë mësuesit të kuptojnë më mirë dhe të jenë në gjendje të integrojnë strategjitë në klasën e tyre" (Cutter 2015, fq.3). Si dhe e përkrahur nga Gholamina (2014) i cili gjithashtu pohon faktin e rëndësishëm të trajnimit të mësimdhënësve mbi përdorimin e teknologjive të reja në klasat e tyre.

Sa i përket qëndrimit negativ, qoftë të vet mësimdhënësit apo të përdorimit të teknologjië, qëndrimi negativ i mësuesit është pasojë e mungesës së besimit, mungesës së mjediseve ose mungesës së trajnimit. Këto mangësi pengojnë për të parë përfitimet e përdorimit të TIK në klasë (Dudeney, 2007). Po ashtu qëndrimet negative të mësuesve ndikojnë në mënyrën e aplikimit të teknologjisë në klasa. Si rezultat, ata refuzojnë përdorimin e teknologjive kompjuterike dhe nuk i integrojnë këto burime në mësimet e tyre (Pourhosein, 2015). Kjo është argumentuar edhe nga Arnó (2012) ku thotë se qëndrimi negativ ndaj teknologjisë ndikon në mënyrën në të cilën mësuesit përdorin teknologjinë klasat e tyre. Për më tepër, Mohaded (2014) shton se studentët janë më të aftë teknologjikisht sesa mësuesit e tyre. Kjo mund të jetë një arsye tjetër që mësimdhënësi mund të refuzojë përdorimin e TIK në klasa. Prandaj, është e rëndësishme që mësuesit të fillojnë të marrin pjesë në programet e trajnimit.

### **1.7. Studime të mëparshme mbi përdorimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze**

Duke u referuar nga autorët që janë përmendur më lart dhe nga studimet e tyre lidhur me TIK-un dhe mësimin e gjuhës angleze, mund të shtojmë se teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) kanë disa përfitime për mësimdhënien dhe të mësuarit. Së pari, nxënësit luajnë një rol aktiv, i cili mund t'i ndihmojë ata të mbajnë më shumë informacione. Tjetra, diskutimet përfshijnë më shumë informacione ku nxënësit mund të bëhen më të pavarur. Më në fund, nxënësit mund të përpunojnë materiale të reja arsimore të cilat ndihmojnë aftësitë e tyre për të mësuar (Costley, 2014).

Warschauer (2000a) përshkroi dy pikëpamje të ndryshme rreth mënyrës së integrimit të teknologjisë në klasë. Së pari, në qasjen njohëse, nxënësit kanë mundësinë të rrisin ndjeshëm ekspozimin ndaj gjuhës dhe të bëjnë njohuritë e tyre. Së dyti, në qasjen sociale, nxënësve duhet t'u jepen mundësi për ndërveprime të mirëfillta shoqërore për të praktikuar aftësitë e jetës reale. Ky objektivi mund të arrihet përmes bashkëpunimit të nxënësve në aktivitete reale.

Teknologjia ndihmon nxënësit dhe mësuesit në studimin e materialeve të kursit për shkak të qasjes së shpejtë të saj. Përparimet në teknologji kanë një rol kryesor në përgatitjen e nxënësve për të përdorur atë që ata mësojnë në çdo lëndë për të gjetur vendin e tyre në fuqinë punëtore botërore. E përkrahur nga Rodinadze (2012) ku pohon se teknologjia lehtëson të mësuarit e nxënësve dhe shërben si një mjet i vërtetë arsimor që lejon të mësuarit të ndodhë (Rodinadze, 2012).

Një nga ndikimet e përdorimit të teknologjisë në klasat e gjuhës është rritja e bashkëpunimit midis mësuesve dhe nxënësve. Kur mësuesit lejojnë që nxënësit të bëhen ndihmës në procesin e mësimdhënies, kjo mund të rrisë besimin e nxënësve. Nxënësve u jepet mundësia të përforcojnë mendimet dhe aftësitë e mësuara tashmë. Nxënësit mund të ndihmojnë mësuesit në integrimin e teknologjisë sepse nxënësit kanë pasur kohë të bollshme për të zotëruar teknologjinë, ndërsa mësuesit punojnë në drejtimin e udhëzimit (Mouza, 2008) ; (Sabzian, 2013).

Gjithashtu, sa i përket aplikacioneve, platformave që nxënësit dhe mësimdhënësit përdorin për të mësuar në gjuhë tjetër/të huaj janë shumë të rëndësishme. Një studimi tjetër i bërë nga Alsaleem (2014) për përdorimin e aplikacioneve WhatsApp në revistat angleze të dialogut për të përmirësuar shkrimin, fjalorin, zgjedhjen e fjalëve dhe aftësinë e të folurit të nxënësve. Bazuar në rezultatet e këtij studimi, u konkludua se WhatsApp tregoi përmirësim në aftësitë e të shkruarit të nxënësve, aftësitë e të folurit, fjalorin dhe zgjedhjen e fjalëve.



Duke u nisur nga ajo se çka u tha me lart për ndikimin e teknologjisë, me theks të veçantë ndikimin e teknologjisë për të mësuar një gjuhë të huaj siç është gjuha angleze, ky punim ka për qëllim të hulumtojë ndikimin e teknologjisë tek nxënësit e ciklit fillor në rrethin e Mitrovicës. Më saktësishtë, do të bëjë hulumtim rreth tre hipotezave të parashtrua në kapitullin në vijim.

## 2. METODOLOGJIA

Metoda që është përdorur në këtë hulumtim janë metoda kuantitative (sasiore) e cila mbështetet në të dhëna statistikore. Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptojmë ndikimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze tek nxënësit e ciklit fillor në rrethin e Mitrovicës.

Duke u mbështetur në shqyrtimin e literaturës, ky punim ka ngritur këto hipoteza:

**Hipoteza e parë (H1):** Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në konstruktet e instrumentit (Menaxhimi i klasës, Integrimi i TIK-ut, Qasja pozitive e mësimdhënësve, Motivimi i nxënësve, Përdorimi i TIK në klasë në mësimin e gjuhës angleze).

**Hipoteza e dytë (H2):** Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit.

**Hipoteza e tretë (H3):** Përvoja e punës ndikon në përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze.

### 2.1. Pjesëmarrësit

Hulumtimi është fokusuar në shkolla fillore të Komunës së Mitrovicës, ku popullata e këtij studimi kanë qenë mësimdhënësit e gjuhës angleze klasa 1-9 si dhe mësimdhënës të kurseve të gjuhës angleze. Numri i popullatës që ka marrë pjesë në këtë hulumtim ishte 15. Mostra që është përzgjedhur ka qenë në mënyrë sistematike me 15 pyetësor. Mostra është shpërndarë në 13

		N	%	shkolla fillore
Gjinia	Femër	9	60	dhe 2 kurse të gjuhës angleze
	Mashkull	6	40	
Grup mosha	20-30	7	46.7	
	31-40	3	20.0	
	41-50	1	6.7	
	50 e më shumë	4	26.7	
Vedbanimi	Urban	13	86.7	
	Rural	2	13.3	
Përvoja e punës	1-3 vjet	5	33.3	
	4-10 vjet	3	20.0	
	11-15 vjet	5	33.3	
	16 ose më shumë vjet	2	13.3	

në Komunën e Mitrovicës

**Tabela 1.** *Të dhënat përshkruese për gjinin, grup moshën, vendbanimin dhe përvojën e punës të pjesmarrëve në hulumtim*

## ***2.2. Instrumenti***

Instrumenti që është përdorur për realizimin e këtij hulumtimi janë pyetësorët të cilët kanë qenë të standardizuar nga hulumtimet “Teaching and Learning with Technology: Effectiveness of ICT Integration in Schools” 2015, me autor Simin Ghavifek dhe “Foreign language teachers’ technology beliefs and implementation factors: a mixed methods study” 2016, me autor Brittany Ann Garling. Këta pyetësor kanë qenë të hapur për përdorim dhe pas sigurimit të tij është bërë përshtatja në kontekstin tone dhe pilotimi i tij. Pyetësi është i ndarë në dy seksione, pjesa e parë që përbëhet nga pyetjet demografike që lidhen me grup moshën, gjininë, vendbanimin dhe përvojën e punës dhe seksioni i dytë që janë gjithsej 18 pyetje të ndara në 5 konstrukte siç janë: përdorimi i TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze, motivimi i nxënësve, qasja pozitive e mësimitdhënësve, integrimi i TIK-ut dhe menaxhimi i klasës.

## ***2.3. Mënyra e mbledhjes së të dhënave***

Për mbledhjen e të dhënave që realizohet me anë të instrumentit, fillimisht është kërkuar leja nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë (DKA), dhe nga drejtorët e shkollave. Ky pyetësorë është realizuar prej datës 18.02.2021 deri më datën 04.03.2021, pra të dhënat janë mbledhur gjatë muajit Shkurt dhe Mars.

## ***2.4. Analizat***

Përmes programit për analizën e të dhënave statistikore SPSS 21 (Paketës Statistikore për Shkencat Shoqërore) janë përpunuar të dhënat e mbledhura. Analizat e të dhënave janë kryer

përmas këtyre analizave: analiza descriptive dhe interferiale me anë të mesatares aritmetike (MA) dhe devijimit standard (DS), dhe analiza e T-testit.

### ***2.5. Apekti etik***

Studimi u zhvillua duke i respektuar çështjet etike duke filluar nga raportimi i literaturës së përdorur, pjesëmarrja vullnetare e pjesëmarrësëve në hulumtim, plotësimi i pyetësorëve ishte anonim me të dhëna konfidenciale. Siguria e secilit pjesëmarrës për këto të dhëna do të përdoret vetëm për këtë studim duke i respektuar deri në fund të këtij hulumtimi.

### ***2.6. Kufizimet e hulumtimit***

Mos përfshirja e nxënësve ka qenë një kufizim për hulumtimin tonë pasi nuk kemi patur mundësi t'i fusim në hulumtim. Dhe po ashtu gjendja pandemike që gjendet shteti ynë ka qenë një kufizim për këtë hulumtim.

### 3. REZULTATET

Mbledhja e informacioneve lidhur me ndikimin e teknologjisë në mësimin e Gjuhës Angleze është realizuar nëpërmjet mësimdhënësve të ciklit të ulët në shkollat fillore të Komunës së Mitrovicës, si dhe pas shqyrtimit të teorive përkatëse, kemi arritur në gjetjet që do t'i prezentojmë në vazhdim. Ky hulumtim ka parashtruar tre hipoteza:

**Hipoteza e parë (H1):** Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në 5 konstruktet e instrumentit.

**Hipoteza e dytë (H2):** Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit.

**Hipoteza e tretë (H3):** Përvoja e punës ndikon në përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze.

Lidhshmëria e hipotezës së parë (H1): Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në konstruktet e instrumentit, me të dhënat nga Tabela 2 tregojnë se, Analiza e T-testit e cila u zhvillua për të parë dallimet ndërmjet mësimdhënësve në konstruktet e instrumentit, tregoi dallime të rëndësishme statistikore vetëm në konstruktin/shkallën menaxhimi i klasës  $t(70)=-2.15$ ,  $p = 0.041$ . Mësimdhënësit femra treguan vlera më të larta (MA=5.61, DS=.63) krahasuar me mësimdhënëset meshkuj (MA=1.83, DS =2.63). Në konstruktet e tjera, dallimet nuk kanë rëndësi statistikore.

Tabela 2. Mesi aritmetik dhe Devijimi Standard sipas Gjinisë kundrejt Konstrukteve të Instrumentit

	Gjinia	N	MA	DS
Menaxhimi i klasës	Femër	9	5.6190	.63503
	Mashkull	6	1.8333	2.63204
Integrimi i TIK-ut	Femër	9	4.4286	.35714
	Mashkull	6	5.4762	1.94552
Qasja pozitive e mësimdhënësve	Femër	9	3.4667	.44721
	Mashkull	6	3.6000	.55136
Motivimi i nxënësve	Femër	9	3.3194	.30046

	Mashkull	6	3.6042	.76000
	Femër	9	4.2963	.26644
Përdorimi I TIK në klasë në mësimin e gjuhës angleze	Mashkull	6	5.0926	1.56097

Sa i përket e hipotezës së parë (H1): Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në konstruktet e instrumentit, dhe të dhënave nga Tabela 3 tregojnë se, përdorimi i TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze (MA=3.43, DS=.527) dhe menaxhimi i klasës (MA=3.70, DS=.621) janë konstruktet që kanë treguar vlerat më të larta. Cka do të thot se mësimdhënësit e përdorin teknologjinë në mësimin e gjuhës angleze në klasë si dhe menaxhimi i klasës përmes përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze e lehtëson mësimin e gjuhës angleze për nxënësit.

Tabela 3. *Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard për Konstruktet e Instrumentit*

	Përdorimi I TIK në klasë në mësimin e gjuhës angleze	Motivimi i nxënësve	Qasja pozitive e mësimdhënësve	Integrimi i TIK në klasë	Menaxhimi i klasës
N	15	15	15	15	15
MA	3.4333	4.6148	3.5200	4.8476	3.7048
DS	.52794	1.03626	.47689	1.30648	.62145

Tek hipoteza e dytë (H2): Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit, dhe nga ndërlidhja me të dhëna përshkruese për pyetjen në lidhje me numrin e trajnimeve të ndjekura dhe me pohimin “Unë mund të kem një mësimdhënie efektive pa përdorimin e TIK-ut në mësimin e gjuhës angleze”, të dhënat nga tabela 4 tregojnë se, mësimdhënësit që nuk kanë të ndjekur ndonjë trajnim për përdorimin e TIK-ut ose ka një numër të vogël të përfundura pohojnë se mësimdhëniet e tyre është efektive edhe pa përdorimin e TIK-ut në klasë, ndërkaq pjesa më e madhe e


mësimdhënësve që kanë ndjekur numër më të madhë të trajnimeve nuk pajtohjen me pohimin e dhënë.

Tabela 4. Të dhënat përshkruese për pyetjet 6 dhe 4

		Unë mund të kem një mësimdhënie efektive pa përdorimin e TIK-ut ne mësimin e gjuhës angleze.					Total
		Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	
Kam ndjek _____ trajnime të ndryshme për përdorimin e teknologjisë në klasë.	0-5	0	1	3	0	3	7
	6-10	4	3	0	1	0	8
Total		4	4	3	1	3	15

Gjithashtu nga pyetja “Unë kam nevojë për trajnim dhe zhvillim profesional në përdorimin e TIK-ut ne mësimdhënien e gjuhes angleze”, që lidhen me hipotezën e dytë (H2): Mësimdhënësit e gjuhes angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit, të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e mësimdhënësve, që nuk kanë të përfunduar ndonjë trajnim për përdorimin e teknologjisë në klasë ose që ka të përfundur një numër të vogël të trajnimeve, mbështesin pohimin e dhënë, cka do të thotë se nevojitet organizimi i trajnimeve të ndryshme që mundësojnë zhvillimin professional të mësimdhënësve në këtë aspekt.

Sa i përket hipotezës së dytë (H2): Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshme për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit, Grafiku 1 në vazhdim, ofron informacion për pyetjen lidhur me ndjekjen e trajnimeve të mësimdhënësve që janë përgjigjur si në vijim:



Grafiku 1. Numri i trajnimeve që mësimdhënësit kanë ndjekur për përdorimin e teknologjisë në klasë

Nga grafiku mund të shihet se pjesa më e madhe e mësimdhënësve (86.7 %) kanë ndjekur një numër të vogël të trajnimeve sa i përket përdorimit të teknologjisë në klasë, madje një pjesë e tyre nuk kanë ndjekur asnjë trajnim të tillë. Ndërsa vetëm 13.3% mësimdhënësve kanë ndjekur 6-10 trajnime.

Lidhshmëria e hipotezës së tretë (H3): Përvoja e punës ndikon në përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze, me të dhënat nga tabela 5 më sipër mund të vërejmë moshën, përvojën e punës dhe trajnimet e ndjekura nga ana e mësimdhënësit për mësimnxënien e gjuhës angleze, ku janë bërë analiza e minimumit, maksimumit , mesatares dhe devijimit standard. Duke u bazuar në të dhënat statistikore ne mund ta kuptojmë se mesatarja e e moshës së mësimdhënësve është 35.40, 9.53 është mesatarja e përvojës së punës dhe 5.00 është mesatarja per trajnimet e ndjekura nga ana e mësimdhënësve.

Tabela 5. Të dhënat deskriptive për moshën, përvojën e punës dhe trajnimet e ndjekura

Unë kam nevojë për trajnim dhe zhvillim profesional në përdorimin e TIK-ut ne mësimdhënien e gjuhës angleze.					
	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
Kam ndjekur trajnime të ndryshme për përdorimin e teknologjisë në klasë.	1	1	2	4	5
Total	1	1	2	6	5

	N	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Mosha	15	24	55	35.40	10.548
Përvoja e punës	15	1	27	9.53	7.927
Kam ndjekur trajnime të ndryshme për përdorimin e teknologjisë në klasë	15	0	17	5.00	4.392




Gjithashtu tek hipoteza e tretë (H3): Përvoja e punës ndikon në përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze, dhe nga ndërlidhja e pyetjes së 4 që lidhet me përvojën e punës së mësimdhënësve me pyetjen e 9, të dhënat nga tabela 6 tregojnë se “Nxënësit do të mësojnë gjuhën angleze më mirë nëse përdorin teknologji në klasat e tyre” mundë të vërejmë se mësimdhënësit që kanë më pak përvojë pune me 1-3 vjetë, e mbështesin këtë pohim se nxënësit mësojnë më shumë nëse përdorin gjuhën angleze në klasë, ndërkaj me rritjen e viteve të përvojës së punës ky pohim nuk mbështetet nga mësimdhënësit.

Tabela 6. *Te dhënat përshkruese për pyëtjet 4 dhe 9*

		Nxënësit do të mësojnë gjuhën angleze më mirë nëse përdorin teknologji në klasat e tyre.			Total
		Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	
Përvoja e punës	1-3 vjet	0	1	7	8
	4-10 vjet	0	0	3	3
	11-15 vjet	1	1	1	3
	16 ose më shumë vjet	0	1	0	1
Total	1	3	11	15	

Nga grafiku i paraqitur përmes analizës përshkruese mund të shohim se shumica e respondentëve kanë deklaruar se në shkollat e tyre posedojnë laboratorë të TIK-ut (86.6) ndërsa në përqindje të vogël (6.6 %) kanë deklaruar se në shkollën e tyre nuk posedojnë laborator të teknologjisë.



Grafiku 2. *Numri i laboratorëve të kompjuterëve në shkollë*

#### **4. DISKUTIME**

Duke u bazuar në të gjeturat e hulumtimit tonë, kuptojmë se:

Hipoteza e parë e cila thekson se “Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në 5 konstruktet e instrumentit” vërtetohet, duke u bazuar në të dhënat statistikore ku mësimdhënëset femra treguan vlera më të larta krahasuar me mësimdhënësit meshkuj. Një rezultat i tillë që vërteton hipotezën më lartë mund ta gjejmë te hulumtimi i bërë nga Arifah (2014), i cili thekson se qëndrimet e mësimdhënësve ndikojnë në mënyrën e implantimit të teknologjisë në klasa. Si rezultat, mësimdhënësit meshkuj ata refuzojnë përdorimin e teknologjive kompjuterike dhe nuk i integrojnë këto burime në mësimet e tyre. Kurse mësimdhënëset femra kombinojnë multimediat dhe metodologjinë e mësimdhënies që është shumë e rëndësishme për të tërhequr vëmendjen e nxënësve drejt mësimin të gjuhës angleze.

Hipoteza e dytë e cila thekson se “Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit” duke u bazuar në të dhënat statistikore mund të shihet se pjesa më e madhe e mësimdhënësve (86.7 %) kanë ndjekur një numër të vogël të trajnimeve sa i perket përdorimit të teknologjisë në klasë. Ndërsa vetëm 13.3% kanë ndjekur me shumë se 6 trajnime mbi përdorimin e teknologjisë në mësimdhënien e gjuhës angleze madje një pjesë e tyre nuk kanë ndjekur asnjë trajnim të till.

Duke theksuar se mungesa e trajnimeve tek shumica e mësimeve ka ndikuar në mungesën e motivimit tek nxënësit. Rezultatet tilla që vërtetojnë hipotezën më lartë mund të gjejmë tek hulumtimet e bëra nga Mohamed (2014) dhe Cutter (2015). Mohamed (2014), thekson se sa i përket aftësive të përdorimit të TIK-ut, mësimeve kanë përvojë të pamjaftueshme me teknologjinë, mungesë besimi, mungesë lehtësirash dhe mungesë trainimi. Pra, mësimeve kanë nevojë për trajnim teknologjik për të dhënë mësim duke përdorur TIK-un. Dhe kjo gjë po ndikon që nxënësit mos të jenë motivuar nga ana e mësimeve duke ndikuar kështu edhe në performancën e nxënësit. Me trajnim të mjaftueshëm të TIK-ut, mësuesit mund të jenë më kompetentë dhe të kalojnë më pak kohë duke përgatitur materialet mësimore.

Gjithashtu Cutter (2015), thekson se është e domosdoshme që mësuesit të ndjekin trajnime për përdorimin e teknologjisë në klase, sepse mungesa e trajnimeve apo udhëzimeve të përdorimit të TIK-ut po ndikon në zhvillimin e aftësive gjuhësore gjithashtu dhe në motivimin e nxënësve.

Hipoteza e tretë e cila thekson se “Përvoja e punës ka lidhje me përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze” duke u bazuar në të dhënat statistikore mund të vërejmë se mësimeve që kanë më pak përvojë pune me 1-3 vjet, e mbështesin pohimin se nxënësit mësojnë më shumë gjuhën angleze në klasë nëse përdorin TIK-un, ndërkohë me rritjen e viteve të përvojës së punës ky pohim nuk mbështetet nga mësimeve dhe se ata nuk pajtohen se nxënësit mund të mësojnë më mirë nëse në klasat e tyre mësimin e gjuhës angleze e bëjnë me ndihmën e TIK-ut. Kurse mesatarja e përvojës së punës është 5.00 kurse devijimi standard (DS=7.92).

Rezultatet tilla që vërtetojnë hipotezën më lartë mund të gjejmë tek hulumtimet e bëra nga Pourhosein (2015) dhe Arifah (2014). Pourhosein (2015), argumenton se ekziston një lidhje midis përvojës kompjuterike të mësuesit dhe qëndrimeve të tyre përpara TIK-ut. Sipas tij, mësuesit më të vjetër ose mësuesit me më shumë përvojë mësimore janë më pak të prirur të përdorin TIK. Përkundrazi, mësuesit e rinj kanë më pak vështirësi për të përdorur teknologjinë në mësimet e tyre. Nga kjo mund të nënkuptohet se pengesat e mësuesit janë mungesa e trajnimit teknologjik dhe niveli më i ulët i aftësive që lidhen me të. Arifah (2014), i cili gjithashtu thekson se në klasat tradicionale ku mësimeve të cilët kanë përvojë më të gjatë të mësimdhënies qëndrojnë përpara nxënësve dhe mbajnë leksione, shpjegim dhe udhëzim përmes përdorimit të dërrasës së zezë ose dërrasës së bardhë, pra nuk aplikojnë TIK-un në klasë. Kurse për

mësimdhësimdhënësit të cilët kanë përvojë më të shkurtë në mësimdhënie përdorin tekste multimediale në klasë që ndihmojnë nxënësit të familjarizohen me fjalorin dhe strukturat gjuhësore.

Pra, nga të gjeturat dhe nga diskutimi mbi të gjeturat mund të thuhet se teknologjia ka ndikim shumë të madh në mësimin e gjuhës angleze. Nga rezultatet e hulumtimit mund të konkludojmë se ndikim të madh kanë mungesa e trajnimeve për TIK-un tek mësimdhënësit, gjë që e bënë të pamundur aplikimin e suksesshëm në klasë si dhe përvoja e punës së mësimdhënësve, ku mësimdhënësit të cilët kanë përvojë më të gjatë në mësimdhënie, nuk përdorin mjaftueshëm teknologjinë. Po ashtu edhe në përdorimin e TIK-ut në klasa ku nga rezultatet e hulumtimit mund të vërehet dallime ku mësimdhënësit meshkuj përdorin më shumë TIK në klasë sesa mësimdhënëset femra.

## **5. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET**

Nga hulumtimi i bërë dhe nga shqyrtimi i literaturës kemi arritur të krijojmë disa konkluzione dhe disa rekomandime, të cilat mendoj se do të përmbledhin punën time në këtë punim.

Duke u nisur nga ajo se çka u tha në kapitujt më lart dhe studiuesit si: Rodinandze (2012), Alsaleem (2014), Peregoy (2012), Warschauer (2000a), Arifah (2014) etj. Të cilët hulumtuan tema për ndikimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze të cilët konkluduan se, përdorimi i teknologjisë për të mësuar një gjuhë të dytë është bërë një domosdoshmëri e vërtetë, po ashtu po bëhet gjithnjë e më shumë e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme sidomos në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze.

Pra sipas hipotezës së parë (H1): Ekzistojnë dallime ndërmjet gjinisë në 5 konstruktet e instrumentit. Hulumtimi tregoi se ka dallim ndërmjet gjinisë femrore dhe mashkullore të mësimdhënësve në konstruktin\ shkallën e menaxhimit të klases ku mësimdhënëset femra treguan vlera më të larta se mësimdhënësit meshkuj. Nga kjo mund të konkludohet se, mësimdhënëset femra menaxhojnë më mirë klasën sesa mësimdhënësit meshkuj.

Gjithmonë duke u bazuar në të gjeturat e hulumtimit tonë dhe hipotezën e dytë (H2): Mësimdhënësit e gjuhës angleze që nuk kanë trajnime të mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit. Shihet që një pjesë e madhe e mësimdhënësve të gjuhës angleze nuk kanë trajnime të mjaftueshme për përdorimin e teknologjisë në klase, por ka edhe prej atyre që nuk kanë trajnime fare dhe një numër shumë i vogël i tyre kanë trajnime të mjaftueshme për përdorimin e teknologjisë gjë që ndikon edhe në motivimin e nxënësve. Nga kjo mund të konkludohet se, shumica e mësimdhënësve të gjuhës angleze në rrethin e Mitrovicës nuk kanë trajnime të mjaftueshme për përdorimin e TIK-ut në klase dhe se nuk i motivojnë mjaftueshëm nxënësit.

Kurse sipas hipotezës së tretë (H3): Përvoja e punës ndikon në përdorimin e TIK-ut në klasë në mësimin e gjuhës angleze dhe duke u bazuar nga të gjeturat e hulumtimit tonë, ku mësimdhënësit që kanë më pak përvojë pune me 1-3 vjet, e mbështesin pohimin se nxënësit mësojnë më shumë gjuhën angleze në klasë nëse përdorin TIK-un. Ndërkaq, me rritjen e viteve të përvojës së punës ky pohim nuk mbështetet nga mësimdhënësit dhe se ata nuk pajtohen se nxënësit mund të mësojnë më mirë nëse në klasat e tyre mësimin e gjuhës angleze e bëjnë me ndihmën e TIK-ut. Pra, mund të konkludohet se mësimdhënësit e gjuhës angleze në rrethin e Mitrovicës, të cilët kanë përvojë më të gjatë në mësimdhënie, nuk përdorin mjaftueshëm TIK-un në klasë në krahasim me mësimdhënësit të cilët kanë më pak përvojë pune në mësimdhënie, të cilët aplikojnë më shumë teknologjinë në procesin mësimor.

Sa i përket rekomandimeve, nga të gjeturat e këtij hulumtimi, mund të rekomandohet për mësimdhënësit e gjuhës angleze të cilët janë faktorë shumë të rëndësishëm dhe që kanë një rol të madh në mënyrën se si ata e organizojnë orën mësimore dhe sa ata përdorin teknologjinë në klasat e tyre. Mund të rekomandohet për mësimdhënësit e gjuhës angleze dhe shkollat në përgjithësi që të krijojnë kushte pra të mundesojnë trajnime për përdorimin e TIK-ut për mësimdhënësit në mënyrë që mësimdhënësit të jenë të aftë që të aplikojnë me sukses TIK-un në klasë dhe që nxënësit të qasen më lehtë në leksionet e tyre. Gjithashtu edhe shkollat të pajisen me numër më të madh të kabineteve të TIK-ut, projektor etj.

Nga shqyrtimi i literaturës dhe nga rezultatet e hulumtimit është konkluduar se teknologjia ka ndikim shumë të madh në mësimin e gjuhës angleze. Duke vërejtur rëndësinë që ka përdorimi i teknologjisë në klasa, mësimdhënësit e gjuhës angleze nuk e përdorin mjaftueshëm TIK-un për t'i arritur objektivat e të nxënësve. Por ajo çfarë mbetet mangësi në aplikimin e teknologjisë në

klasa, është mungesa e trajnimeve të mësimdhënësve të gjuhës anglze, gjë që po ndikon që nxënësit të kenë më të vështirë në qasjen më të lehtë në mësimet e tyre, zhvillimin e aftësive gjuhësore, motivimin, si dhe zhvillimin e aftësive ndërpersonale. Kështu që mësimdhënësit e shekullit 21-të ta aplikojnë sa më shumë TIK-un në mësimdhënie dhe mësimnxënie si një mjet që zhvillon dhe nxit më tej procesin e të mësuarit.

## REFERENCAT

- (ACTFL), A. C. (2014, 11 22). Role of technology in language learning. *American Council on The Teaching of Foreign Languages (ACTFL)*.
- Alsaleem, B. I. (2014). The effect of “WhatsApp” electronic dialogue journaling on improving writing vocabulary word choice and voice of EFL undergraduate Saudi Students. *21st Century Academic Forum Conference Proceedings*, (p. [http://www.readwritethink.org/lesson\\_images/lesson782/Rubric.pdf](http://www.readwritethink.org/lesson_images/lesson782/Rubric.pdf)). Harvard.
- Arifah, A. (2014). *Study on the use of technology in ELT classroom: Teachers’ perspective*. Dhaka, Bangladesh: M.A. Thesis, Department of English and Humanities, BRAC University.
- Arnó, E. (2012). The role of technology in teaching languages for specific purposes courses. *The Modern Language Journal*.
- Bárcena, E. R. (2014). Languages for specific purposes in the digital era.
- Basheer, B. (2013). The impact of Using Technology in teaching English as a Second Language. *English Language and Literature Studies*, 111-116.
- Baytak, A. T. (2011). Experiencing technology integration in education: children’s perceptions. *International Electronic Journal of Elementary Education*, 139-151.
- Becker, H. J. (2000). Findings from the teaching, learning, and computing survey. *Education Policy Analysis Archives*.
- Carrier, M. D. (2017). . Digital Language Learning and Teaching: Research. *Theory, and Practice*.
- Chomsky, N. (1959). A review of BF Skinner’s verbal behavior. *Language*, 26-58.

- Cook, V. (2008b). General models of L2 learning. *Second language learning and language teaching*, 214-234.
- Cook, V. (2008c). Second language learning and language teaching styles. *Second language learning and language teaching*, 235-272.
- Costley, K. C. (2014). The positive effects of technology on teaching and student learning.
- Cutter, M. (2015). Using Technology with English Language Learners in the Classroom. *Education Masters*.
- Dudeney, G. H. (2007). How to teach English with technology. *Pearson Education Limited*.
- Eady, M. J. (2013). Tools for learning: technology and teaching strategies. *Learning to teach in the primary school*, 71-89.
- George, N. O. (2013). A study on the usefulness of Audio-Visual aids in EFL classroom: Implications for effective instruction. *International Journal of Higher Education*, 86-92.
- Gholamina, I. (2014). Application of computer and technology in EFL syllabus design. . *Journal of language teaching and research*, 376-381.
- Grabe, W. &. (2020). *Teaching and researching reading*. New York.
- Graddol, D. (2012). *The impact of macro socioeconomic trends on the future of the English language*. Sweden: Doctoral Thesis at Stockholm University.
- Hoven, D. (1999). A model for listening and viewing comprehension in multimedia environments. . *Language Learning & Technology*, 88-103.
- Imad, M. (2015). The perceptions of students and teachers about the benefits of and barriers to technology aided EFL. *Journal of Littrature, Languages and Linguistics*, 85-99.
- Lam, Y. &. (2002). Teacher-student role redefinition during a computer-based second language project. *Computer Assisted Language Learning*, 295-315.
- Lantolf, J. (2001). Introducing sociocultural theory. *Sociocultural theory and second language learning*, 1-26.
- Lightbown, P. &. (2006). Explaining second language learning. *How languages are learned:Oxford handbook for language teachers*, 29-51.
- Marek, M. (2014). The integration of technology and language instruction to enhance EFL learning.
- Merzifonluoglu, A. G. (2018). Review of Digital language learning and teaching: Research, theory, and practice. *Language Learning & Technology*, 65-68.
- Mohaded, M. (2014). Using technology in EFL/ESL classroom. *International Journal of Humanities and cultural studies*.
- Mollaei, F. (2013). Teachers' perceptions of using technology in teaching EFL. *International Journal of Applied Linguistics & English Literature*, 13-22.

- Morris, M. &. (2014). The importance of English language competency in the academic success of international accounting students. *Journal of Education for Business*, 178-185.
- Mouza, C. (2008). . Learning with laptops: Implementation and outcomes in an urban, underprivileged school. *Journal of Research on Technology in Education*, 447-472.
- Mujtaba, S. M. (2013). The use of Computer Technolgy in EFL Classroom. *Journal of English Language & Translation Studies*, 61-71.
- Myles, F. (2002). Second language acquisition (SLA) research.
- Patel, C. (2013). Use of multimedia technology in teaching and learning communication skill. *International Journal of Advancements in Research & Technology*, 116-123.
- Peregoy, S. &. (2012). Reading, writing and learning in ESL. *A resource book for teachers*.
- Pourhosein, A. B. (2015). What are the barriers in the use of computer technology in EFL instruction? . *Review of European Studies*, 213-221.
- Pourhossein Gilakjani, A. (2017). A review of the literature on the integration of technology into the learning and teaching of English language skills. *International Journal of English Linguistics*, 95-106.
- Rodinadze, S. &. (2012). The advantages of information technology in teaching English language. *Frontiers of Language and Teaching*, 271-275.
- Sabzian, F. P. (2013). Use of technology in classroom for professional development. *Journal of Language Teaching and Research*, 684-692.
- Shehu, M. (2020, 04 03). Roli i teknologjisë në mësimdhënien dhe mësimin e gjuhës së huaj. *Diaspora Shqiptare*.
- Solanki, D. &. (2012). . Use of technology in English language teaching and learning. 150-156.
- Stanley, G. (2013). *Language Learning with Technology: ideas for integrating technology in the classroom*. Cambridge University Press. .
- Warschauer, M. (2000a). The death of cyberspace and the rebirth of CALL. *English Teachers' Journal*, 61-67.
- Ybarra, R. &. (2003). Using technology to help ESL/EFL students develop language skills. *The Internet TESL Journal*.



## SHTOJCA

### FORMULAR PAJTIMI



**UNIVERSITETI I MITROVICES**  
**'ISA BOLETINI'**  
*UkshinKovaqica, p.n. 40000 Mitrovicë*  
*Republika e Kosovës*  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

---

#### **I/E nderuar,**

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të Diplomës. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj këtë hulumtim.

“NDIKIMI I TEKNOLOGJISE NE MESIMIN E GJUHES ANGLEZE TEK NXENESIT E  
CIKLIT FILLOR NE RRETHIN E MITROVICES”

Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen Tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me ju, ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

-----

-----

[Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në vazhdimësi, ju lutem kontaktoni profesoreshën mentor të punimit, Edita Bekteshi, në [edita.bekteshi@umib.net](mailto:edita.bekteshi@umib.net)

### **Pyetësor për mësimdhënësin e gjuhës angleze:**

#### **1. Gjinia**

1. Femër
2. Mashkull

#### **2. Mosha**

1. 20-30
2. 31-40
3. 41-50
4. 50 e më shumë

#### **3. Vendbanimi**

1. Urban
2. Rural

#### **4. Përvoja e punës:**

1. 1-3 vjet

1. Teknologjia është efektive në mësimin e gjuhës angleze dhe	1	2	3	4	5
---	---	---	---	---	---

2. 4-10 vjet

3. 11-15 vjet

4. 16 ose më shumë vjet

**5. Numri i laboratorëve të kompjuterëve në shkollën tuaj**

1. Zero

2. Një deri në dy

3. Tre deri në pesë

**6. Kam ndjekur \_\_\_\_\_ trajnime të ndryshme për përdorimin e teknologjisë në klasë.**

**1. Nuk pajtohem aspak, 2. Nuk pajtohem, 3. Neutral, 4. Pajtohem,**

**5. Pajtohem plotësisht**

besoj se mund ta zbatoj me sukses në klasë.					
2. Shqetësohem se nxënësit e mi do të përdorin burime të internetit siç janë përkthyesit në internet për të bërë detyrat e tyre.	1	2	3	4	5
3. Unë e kam më të lehtë të integrojë kompjuterin në planet e mia të rregullta të mësimin.	1	2	3	4	5
4. Unë mund të kem një mësimdhënie efektive pa përdorimin e TIK-ut në mësimin e gjuhës angleze.	1	2	3	4	5
5. Menaxhimi i një klase të nxënësve në kompjuter është më i vështirë sesa menaxhimi i një klase të studentëve pa kompjuter.	1	2	3	4	5
6. Të mësoj nxënësit se si të përdorin teknologjinë për t'a mësuar gjuhën angleze nuk është detyra ime.	1	2	3	4	5
7. Koha e orës mësimore nuk është e mjaftueshme për mua për të përdorur TIK-un në mësimdhënien e gjuhës angleze.	1	2	3	4	5
8. Unë kam nevojë për trajnim dhe zhvillim profesional në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës angleze.	1	2	3	4	5
Pyetje për nxënësit nga kenveshtrimi i mesimdhënesit					
9. Nxënësit do të mësojnë gjuhën angleze më mirë nëse përdorin teknologji në klasat e tyre.	1	2	3	4	5
10. Interneti është një burim më i mirë i mësimin të gjuhës angleze sesa biblioteka e shkollës.	1	2	3	4	5
11. Për nxënësit mësimi i komponentëve të gjuhës angleze (gramatikë, fjalor dhe prononcim) do të jetë efektiv me përdorimin e teknologjisë.	1	2	3	4	5
12. Për nxënësit mësimi i aftësive në gjuhën angleze (dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi) do të jetë efektiv me përdorimin e teknologjisë.	1	2	3	4	5
13. Nxënësit e kanë të vështirë ta ruajnë vëmendjen gjatë punës në kompjuter.	1	2	3	4	5
14. Përdorimi i TIK-ut ndihmon në zgjerimin e njohurive të	1	2	3	4	5

nxënësit në mësimin e gjuhes angleze.					
15. Përmirëson motivimin e nxënësve për të mësuar gjuhen angleze.	1	2	3	4	5
16. Promovon zhvillimin e aftësive ndërpersonale të nxënësve (p.sh. aftësinë për të punuar me të tjerët).	1	2	3	4	5
17. Motivon nxënësit të përfshihen më shumë në aktivitete për mësimin e gjuhes angleze.	1	2	3	4	5
18. Ndhmon në plotësimin e nevojave individuale të të nxënit të nxënësve.	1	2	3	4	5

**Ju falënderit për kohën dhe përkushtimin tuaj për plotësimin e këtij pyetëtori!**